



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 26/3 Prot

Tiranë, më 08.03.2021

V E N D I M

Nr.21, datë 08.03.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, në lidhje me disa parregullsi të pretenduara gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave në Fushën e Drejtësisë dhe Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë (kategoria II-b”, me kod # 3278), paraqitur nga konkurrentja **.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të një kërkesë të paraqitur prej aplikantes, *****.

Vërej se:

Nëpunësja ***** , nëpërmjet një kërkesë protokolluar me nr. 908 prot., datë 07.12.2020, ka ngritur disa pretendime për parregullsi të lëjuara nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë realizimit të procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin e punës “Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave në Fushën e Drejtësisë dhe Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë, *kategoria II-b*”, me kod# 3278.

Në informacionin e përcjellë nëpërmjet ankesës së saj, konkurrentja ***** , ka ngritur pretendimin se vendimi i Departamentit të Administratës Publike, për skualifikimin e saj në fazën e verifikimit paraprak, gjatë procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin në fjalë, me argumentin se ajo ndërkohë është e pezulluar nga shërbimi civil, është i paligjshëm. Ankuesja arsyeton se, legjislacioni për shërbimin civil nuk parashikon ndalesë për nëpunësin

civil që është i pezulluar nga shërbimi civil, për arsye të ligjshme, që të marrë pjesë në konkurrime për vende të lira pune.

Në përmbajtjen e informacionit të dërguar prej saj, pretendohet se nga ana e DAP, gjatë procedurës së shpalljes si vend të lirë të këtij pozicioni pune, në rublikën “*kriteret e veçanta*”, është hequr kërkesa: “*Njohuri të gjuhës Angleze*”. Ky veprim, sipas saj vlerësohet si i parregullt, pasi njohuritë në këtë gjuhë të huaj, janë element i domosdoshëm për këtë pozicion pune. Heqja e këtij kriteri, sipas ankueses, është bërë me qëllim “favorizimi” të konkurrentes ***** , për të cilën pretendon se nuk e plotëson kriterin e gjuhës së huaj.

Pas marrjes së informacionit të mësipërm ka nisur verifikimi paraprak i këtij rasti nga Komisioneri, duke kërkuar sqarime dhe dokumentacionin e nevojshëm nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Drejtësisë, të cilët u përgjigjën në lidhje me pretendimet e ankueses, respektivisht me aktet nr. 6771/1, datë 08.01.2021, “*Kthim përgjigje tuajës*” dhe nr. 7815/2 datë 08.01.2021, nga përmbajtja e të cilave rezultoi si më poshtë:

Në lidhje me pretendimin për parregullsi në skualifikimin e ankueses në fazën e verifikimit paraprak, për shkak se ndërkohë ishte e pezulluar nga shërbimi civil, në përgjigjen e DAP sqarohet se kjo konkurrenca është nëpunëse civile në kategorinë e ulët drejtuese që nga viti 2015 dhe bazuar në kërkesën e saj, me vendimin nr. 259, datë 28.09.2020 të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, ajo është pezulluar nga shërbimi civil për një periudhë 3-mujore (*deri në datën 31.12.2020*). Më tej, DAP e pranon faktin se në datën 14.11.2020, aplikantja ***** , ka ngarkuar në sistem dokumentacionin e saj për të aplikuar për procedurën e ngritjes në detyrë në pozicionin e punës objekt ankese.

Nga verifikimi i materialeve të dorëzuara prej ankueses, rezultoi se DAP, në datën 26.11.2020, e ka njoftuar atë nëpërmjet postës elektronike, për faktin se nuk është kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të procedurës së ngritjes në detyrë, pasi rezultoi e pezulluar nga shërbimi civil për një periudhë 3-mujore, e njëkohësisht, ajo është informuar se ka të drejtën e ankimimit sipas ligjit.

Konstatohet se nga ana e ankueses është ushtruar e drejta e ankimit, pasi në datën 26 nëntor 2020 (*nëpërmjet postës elektronike*), ajo është ankuar në DAP, duke kundërshtuar moskualifikimin në fazën tjetër të konkurrimit. Rezulton se, në datën 01 dhjetor 2020 (*po nëpërmjet postës elektronike*) aplikantja ka marrë përgjigje nga DAP, në të cilën sqarohet atyheja e moskualifikimit dhe rruga që duhet të ndiqet për të kërkuar rikthimin në shërbimin civil (*këto materiale janë vënë në dispozicion të Komisionerit, bashkëlidhur me në përgjigjen e DAP*).

Sipas akteve të administruara, nuk evidentohet asnjë akt që të vërtetojë faktin që aplikantja të ketë vijuar më tej procesin, me ndonjë kërkesë për rikthim në shërbimin civil, pas pezullimit, sipas legjislacionit të shërbimit civil, por ka vijuar të kërkojë të drejtën e saj në gjykatë, me depozitimin e një kërkesë për sigurim padie, ndaj DAP. Provohet që kjo

kërkesë është refuzuar nga Gjykata, me vendimin e saj të datës 04.12.2020 (shih e-maili i dërguar Komisionerit në datën 21.12.2020).

Duke analizuar bazën ligjore që rregullon institutin e pezullimit, vërejmë se në përmbajtjen e nenit 53 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pezullimi përkufizohet në këtë mënyrë: “pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies në shërbimin civil...”. Më tej, në pikën 15/1, të Kreut II “Përfundimi i periudhës së pezullimit”, të vendimit nr. 124 datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, përcaktohet se:

- Nëpunësi civil njofton institucionin për rikthimin në punë, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara datës së përfundimit të afatit të pezullimit.

*E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastet kur **nëpunësi civil do të ndërpresë periudhën e pezullimit më shpejt se afati** për të cilin i është miratuar pezullimi.*

Në këto kushte, nëpunësi civil i cili kërkon të ndryshojë marrëdhënien në shërbimin civil, duhet që, paraprakisht të paraqesë pranë burimeve njerëzore të institucionit ku ka ushtruar detyrën, të cilat i kanë miratuar kërkesën për pezullim, ose pranë njësisë përgjegjëse (DAP), një kërkesë për kthim nga pezullimi, duke shprehur në këtë mënyrë vullnetin e nëpunësit të pezulluar për të vazhduar marrëdhënien me shërbimin civil.

Nga materialet e dërguara nga DAP, si edhe nga vetë provat e dërguara prej ankueses në postën elektronike të Komisionerit info@kmshe.al, rezultoi se nuk ka asnjë kërkesë të paraqitur prej saj për rikthimin në shërbimin civil. Për më tepër, rezulton se nga ana e ankueses, është paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrje të afatit të pezullimit, e protokolluar pranë DAP me nr. 6709 datë 17.12.2020, e cila në atë kohë ishte në fazën e shqyrtimit, por që nuk është miratuar nga njësia e burimeve njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar kthimin e ankueses në pozicionin e mëparshëm të punës në datën 31.12.2020 (shih vendimin e njësisë së burimeve njerëzore të MD, nr. 268 datë 30.12.2020 “Për mos miratimin e kërkesës për shtyrje të afatit të pezullimit të statusit të nëpunësit civil të *****”).

Në lidhje me sqarimin e pretendimit tjetër të ankueses për parregullsi që kanë lidhje me procedurën e shpalljes si vend të lirë të pozicionit të punës objekt shqyrtimi, për shkak të heqjes si kriter “Njohuri të gjuhës Angleze”, në rublikën “kriteret e veçanta” nga ana e Departamentit të Administratës Publike, me qëlim “favorizimi” të konkurrentes ***** , Komisioneri kërkoi nga DAP dhe Ministria e Drejtësisë, përshkrimin e punës për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave në Fushën e Drejtësisë dhe Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe një informacion të detajuar për arsyet e publikimit të këtij pozicioni pa kriterin e njohurive në gjuhën angleze.

Në përmbajtjen e përgjigjes së tyre sqarohet se, në përputhje me pikën 18, të kreut IV, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe Klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe

Institucionet e Pavarura”, i ndryshuar, përshkrimi i punës për pozicionin e mësipërm, pasi është miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MD, është përcjellë pranë DAP me shkresën nr. 6579 prot., datë 20.10.2020, për miratim.

Rezultoi se DAP, parimisht është shprehur dakord në këtë rast, por ka kërkuar disa rregullime në lidhje me kriterin preferencial për njohuritë e gjuhës së huaj (*me shkresën nr. 5194/1 datë 29.10.2020*), konkretisht duke ju referuar përshkrimit të punës, nëndarja XII e formularit, rubrika “*Kërkesat e posaçme*”, pika “*Tjetër*”, parashikohej që nëpunësi duhet “*të ketë njohuri shumë të mira të një gjuhe të huaj, preferohet anglisht/italisht*”.

Departamenti i Administratës Publike ka sqaruar se ka kërkuar rishikimin e kësaj pike, për faktin se *përcaktimi preferencial* lidhur me njohuritë e gjuhëve të huaja është i panevojshëm në shpalljen për publikim, pasi për efekt rekrutimi kriteret apo aftësitë preferenciale nuk pikëzohen.

Sekretari i përgjithshëm i MD, pasi ka marrë në konsideratë vërejtjet e DAP, me shkresën e tij nr. 6579/1 datë 09.11.2020 ka dërguar për miratim përshkrimin e korrigjuar të punës, për të cilin DAP, pas shqyrtimit, ka shprehur dakordësinë e tij, me shkresën nr. 5739/1 datë 17.11.2020.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se janë respektuar të gjitha kërkesat procedurale që kërkon ligji dhe akti nënligjor që e rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, në rastin e rishikimit të përshkrimit të punës, për një pozicion që është pjesë e shërbimit civil.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për probleme në dokumentacionin e aplikantes ***** (*dokumentacion i cili është paraqitur për njohje Komisionerit nga DAP në përgjigjen e tij*), rezulton se, kjo punonjëse, në momentin e konkurrimit ka qënë nëpunëse civile në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit, Jetësimit të prioritetëve dhe Statistikave, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave në Fushën e Drejtësisë*”, kategoria III-a, në Ministrinë e Drejtësisë dhe është emëruar në këtë pozicion pune me aktin nr. 5198 datë 09.07.2018 të DAP. Kjo punonjëse ka shërbyer në Ministrinë e Drejtësisë që prej Korrikut të vitit 2011 dhe vërtetohet se ajo është e diplomuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, në vitin 2005 dhe zotëron një diplomë të integruar të Nivelit të Dytë, të Fakultetit të Drejtësisë në univeritetin jo publik “*Justiniani i I*”(viti akademik 2006-2010).

Në CV e dorëzuar, në rubrikën e gjuhëve të huaja, është e shprehur se është njohëse e gjuhës angleze e vërtetuar nga një certifikatë e Fondacionit “*Praktikimi Gjuhës*”, lëshuar nga “*Language school in Albania*”, viti 2004, si edhe njohëse e gjuhës Italiane, certifikuar nga Instituti Italian i Kulturës në prill 1999 (*shënimi në CV, por nuk ka dokument të dorëzuar në dosje*).

Në këto kushte, në lidhje me pretendimin e ankueses se aplikantja ***** “*nuk e njeh gjuhën angleze*”, Komisioneri nuk është institucioni kompetent që të vërtetojë se sa njohuri ka aplikantja në fjalë, por në bazë të dokumentacionit rezulton që ajo ka njohuri të certifikuara dhe për më tepër, njohja e gjuhës angleze nuk është një kërkesë specifike e parashikuar në përshkrimin e punës.

Nga analiza e dokumentacionit që materializon procedurën për plotësimin e pozicionit të punës në fjalë, i cili është administruar nga Komisioneri, rezulton se nuk evidentohen shkaqe të arsyeshme për anulimin e procedurës së rekrutimit, pasi nuk u konstatuan parregullsi gjatë fazave të zhvillimit të saj.

Përfundimisht, nisur nga sa më sipër, arrijmë në përfundimin se në rastin e pretendimeve të paraqitura nga ankuesja *****, konkurrencte për procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave në Fushën e Drejtësisë dhe Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë*” (kategoria II-b”, me kod# 3278), nuk janë evidentuar shkaqe të arsyeshme për vazhdimin e hetimit të mëtejshëm administrativ, pasi vlerësohet se procedura e ndjekur nga Departamenti i Administratës Publike, është kryer në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Nga ana tjetër, konstatohet se gjatë zhvillimit të këtij hetimi administrativ, ankuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë padi, në datën 7 janar 2021, me objekt paligjshmërinë e shkresave/vendimeve të DAP, të datës datë 26 nëntor dhe 7 dhjetor 2020, që kanë të bëjnë me konkurrimin që analizuam më sipër, duke argumentuar se ato janë të pabazuara në legjislacionin e shërbimit civil.

Nisur nga sa më sipër, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, sipas të cilit institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se në këtë rast, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ, pasi mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga gjykata, e cila do të vendosë edhe për zgjidhjen e pasojave të aktit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të regjistruar me *nr. 908 prot., datë 07.12.2020*, në lidhje me procedurën e konkurimit për ngritje në detyrë të aplikantes ***** dhe arkivimin e çështjes, pasi rasti është duke u shqyrtuar nga Gjykata.
2. Të njoftohet për këtë vendim Ministria e Drejtësisë, DAP dhe aplikantja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha